



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:149076

Datë: 30.10.2020

Numri i dokumentit: 01231418

PKR.nr. 182 -19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti Për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Zyhdi Haziri, dhe anëtarët e trupit gjykues Naser Maliqi dhe Blerim Beshtica, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. M, nga Gjilani, të cilin me autorizim e mbron av. Rrustem Latifaj, nga Gjilani, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndaja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹ sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani - Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr. 116/2019, të datës 26.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik, më datë 19.10.2020, bie dhe publikisht shpall këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari B. M nga i ati A dhe nëna Xh, e lindur Sh., i indur me datë... në Gjilani ku edhe jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse në mënyrë të paautorizuar e me qëllim shitje apo shpërndarje ka blerë dhe siguruar substancë narkotike të llojit “marihuanë” me peshë prej 976.60 gram në katër paketime, të vendosura në automjetin e markës “Mercedes” me tabela... dhe atë dy paketime nën ulësen e vozitësit dhe dy paketime nën ulësen e pasagjejrës e që më datë 09.07.2019 rreth orës 11,30 është ndalur nga ana e policisë së Kosovës në rrugën e fshatit Komuna e Kamenicës në drejtim të pikës kufitare, ku gjatë kontrollimit i është gjetur substanca narkotike dhe e njejta i është konfiskuar përkohësisht.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.06-L-74, i datës 23.11.2018, i cili ka hyrë në fuqi më 14.01.2019.

Me çka kanë kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndaja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës ligjore dhe nenit 4, 7,17,21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe nenit 267 par. 5. 365 dhe 451 të Kodit të Procedurës Penale², të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME BURG DHE ME GJOBË

Të akuzuarit B. M, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej **500 (pesëqind euro) euro** te cilat dënime do te ekzekutohen pesëmbëdhjetë dite nga dita e plotefuqishmerisë se këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 09.07.2019 deri me date 02.08.2019.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskohet substanca narkotike e llojit “marihuan”, me peshë prej 976,60 gram e cila sasi mund të asgjësohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe konfiskimi i automjetit e markës “Mercedes” me tabela

Obligohet i akuzuari që ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga **50 (pesëdhjet) euro**, shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe në emër të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m i

1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr. 116/2019, të datës 26.07.2019, ndaj të akuzuarit B. M, nga Gjilani për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1. të KPK-ës, dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallën fajtorë dhe të dënohen me dënim meritator sipas ligjit.

Gjatë fjalës përfundimtare, prokurori Shaban Spahiu, ka deklaruar se mbetem në tërësi pran aktakuzës PP.nr.116/2019 të datë 26.07.2019, mëtutje i njejtë ka deklaruar se edhe pas mbajtjes së seancave gjyqësore dhe shtjellimit të provave materiale është vërtetuar se i akuzuari ditën kritike i është gjetur nga ana e policisë sasia narkotike në sasi prej 976,60 gram dhe e njejtë i është sekuestruar, andaj konsideroj se me pa mëdyshje është vërtetuar se i njejtë e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë andaj propozoj trupit gjykues që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptoj dënim meritator sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. M av. Rrustem Latifaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ta ketë kryer veprën penale që i vihet në barrë, me arsyetim se i njejtë nuk ka pasur njohuri se i është

vendos sasia narkotike në veturën e tij, ngase një ditë më parë i akuzuari ia ka dhënë automjetin shokut të tij i quajtur A. R, për të shkuar në Prishtinë dhe jemi të bindur se i akuzuari nuk ka pasur dijeni për këtë sasi të narkotikut në veturën, e tij, ngase gjatë ndaljes nga policia ditën kritike ka qenë i habitur për sasinë narkotike dhe i propozoj trupit gjykues që i akuzuari të lirohet nga përgjegjësia, ndërsa nëse gjykata gjenë elemente të kryerjes së kësaj vepre penale propozoj ti shqiptohet një denim sa më të but, ngase edhe me një denim të tillë do të arrihet qëllimi i denimit, ngase i njëjti është për herë të parë në gjykatë dhe edhe me një denim më të but do të arrihet qëllimi i denimit.

I akuzuari B. M në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrahu në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe është e vërtetë se në veturën time është gjetur sasia narkotike por nuk e di se nga kush është vendosur sasia narkotike dhe propozoj trupit gjykues të më liroj nga kjo përgjegjësi penale.

2. provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor:

Testi fushor i substancës narkotike

Raporti i shiqimit nga vendi i ngjarjes nga ana e Policisë së Kosovës si dhe fotot e bëra.

Vërtetimi mbi konfiskimin e substancës narkotike si dhe automjetin e tipit “Mercedes” me tabela të regjitrimit ...,

Raporti mbi ekspertimit e substancës narkotike të bërë nga Agjensioni i Forenzikës në Prishtinë e datë 12.09.2019

Raporti i Agjensionit të Forenzikës lidhur me ekzamiminin e gjurmëve të vijave papilare të gishtrinjëve të datë 29.08.2019.

3. deklaratat e të akuzuarit B. M

I akuzuarit B. M në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është e vërtetë se një ditë para intervizimit në Polici e kam dhënë veturën time në shërbim të tipit “Mercedes” një personi nga Bujanovici A. R dhe të nesërmen jam ftuar përmes celularit nga i njëjti person për të pirë kafe në kafiterin e cila gjenden në kufi me Serbinë dhe në shkuarje e ku kam vrejtur një automjet të policisë i cili vinte nga ana e kundërt e të cilët ma kanë bllokuar rrugën dhe duke më obliguar që ta hapi bagazhin e automjetit dhe në kontrollim e sipër nën dy ulëset e para të veturës janë gjetur kater paketime të substancës narkotike për të cilën kam shprehur habinë për shkak të mosdijësisë së vendosjes së tyre, ku policia gjat ndaljes dhe kontrollimit të automjetit nuk kanë përdorur ndonjë dhunë fizike apo psikike ndaj meje, njëherit as që kam pasur ndonjë mosmarrëveshje para ditës kritike me personin e quajtur A. R e ku më pastaj jam arrestuar nga të njëjtit dhe lidhur me këtë kam dhënë deklaratë në Polici dhe në Prokurori.

4. Elementet e veprës penale

Veprimet me të cilat kryhet kjo vepër penale kryhet me dashje dhe e njëjta vepër dëmton shëndetin e njerëzve ndërsa pasojat e kryerjes se kësaj vepre përmban rrezikshmërinë shoqërore dhe se kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm për mbajtjen e pa autorizuar të narkotikut. Në nenin 267 par.1 të KPRK-së, thuhet se “Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet”.

5. gjendja faktike e vërtetuar dhe analizimi i provave materiale.

Trupi gjykues pas analizimit me kujdes të të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka gjetur dhe vërtetuar se duke u bazuar në deklaratën e të akuzuarit B. M të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ku kishte deklaruar se është e vërtetë se ditën kritike në vozitje e sipër në drejtim të fshatit Karaqev e që të qon te kafitria është ndaluar nga policia dhe është gjetur një sasi narkotike nën dy karrikat e para të të njejtës veturë “Mercedes” dhe provave materiale të testit fushor të substancës narkotike, fotografit e bëra në vendin e ngjarjes nga Policia e Kosovës dhe dëshmia mbi konfiskimit sasisë narkotike dhe automjetit të shfrytëzuar ditën kritike si dhe raporti i Agjensisë së Forenzikës mbi gjurmëve të gishtrinjëve të gjetura në keset me sasinë narkotike ku vërtetohet se gjurmët e gishtrinjëve janë të të akuzuarit B. M dhe ate të gishtritit të madh të dorës së djathtë e që janë në përputhshmëri të plotë me gishtin e madh të të akuzuarit B. M, andaj Gjykata duke bërë lidhshmërinë e deklaratës së të akuzuarit B. M të dhënë në shqyrtimin gjyqësor si dhe provat tjera B. M e ka kryer veprën penale që i vëhet në barrë nga neni 267 par.1. të KPRK-ës.

I akuzuari B. M në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka tentuar ti ik përgjegjësisë penale duke deklaruar se me dhunë nga ana e policisë është obliguar ta nxjerr sasinë narkotike nga vendi i fshehjes së sasisë narkotike nën karrikat e para të veturës por Gjykata ka gjetur se në raportin policor, Policia e ka nxjerr sasinë narkotike nga vetura e jo i akuzuari, e njëherit edhe vet i akuzuari në seancën gjyqësore ka deklaruar se nga ana e Policisë nuk është përdor kurfar dhune fizike apo psikike ndaj tij, kjo dëshmon i njëjti është duke tentuar ti ik përgjegjësisë penale duke aluduar tek personi i quajtur A. R nga Bujanovci.

5. Vendimi i trupit gjykues për shpalljen fajtor të të akuzuarit

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike, kryetari i trupit gjykues ka shpallur fajtor të akuzuarin B. M, për kryerjen e veprës penale të lartcekur, ngase veprimi i të njëjtit i përmbanë të gjitha elementet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit B. M, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, trupi gjykues ka marrë për bazë këto rrethana: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B. M, sjelljen e mire, pendimin e kryerjes së kësaj vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë për bazë natyrën e veprës penale, sasinë narkotike, qëllimin e kryerjes së kësaj vepre penale dhe rrezikshmërinë shoqërore.

6. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) vite dhe dënimi me gjobë në shumë prej nga 500 € (njëmijë euro) ndaj të pandehurit B. M duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lart, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Përveç këtyre, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim do të mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për dënimin plotësues

Duke u bazuar në nenin 92 paragrafi 1, i cili parasheh “Pasuria ose mjeti që është përfituar me vepër penale konfiskohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës”, Kryetari i trupit gjykues ka vendosur që ndaj të akuzuarit, përveç dënimit kryesor, ti shqiptoj edhe dënimin plotësues marrja - konfiskimi i sasisë narkotike dhe vetura e markës “Mercedes” me targa të regjistrimit

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPRP-së, ka vendosur që i akuzuari të detyrohet që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 35 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 182-19, e dt. 19.10.2020

Sekretarja Juridike
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues
Zyhdi Haziri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.